

VENDIM
Nr.1173, datë 6.11.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN E NGJARJEVE
KULTURORE, ARTISTIKE DHE SOCIALE NGA ORGANET E QEVERISJES
QENDRORE DHE INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE, TË PAVARURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 "Për artin skenik", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Rregulla të përgjithshme:

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore dhe artistike e të veprimtarive të lidhura me to nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura.

II. Procedurat e organizimit:

2. Titullari i institucionit urdhëron, me shkrim, blerjen e shërbimit e të mallrave, për zhvillimin, prodhimin apo bashkëprodhimin e programeve kulturore, sociale dhe artistike nga operatorët e fushës, duke parashikuar, për çdo rast, objektin, nevojën e kryerjes së programit, fondin limit dhe përbërjen e komisionit, për ndjekjen e procedurave.

3. Përzgjedhja e operatorëve të specializuar, në varësi të llojit të ngjarjes, të bëhet sipas kushteve të mëposhtme:

a) Përvojës në organizimin e ngjarjeve;

b) Çmimit të ofruar nga operatorët e specializuar.

4. Komisioni për ndjekjen e procedurave dhe hartimin e dokumenteve përbëhet nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve janë specialistë të fushës.

5. Komisioni, brenda një periudhe kohore 5-ditore nga data e daljes së vendimit, u shpërndan, me korrespondencë zyrtare, operatorëve/agjencive të specializuara ftesën për negociata, e cila duhet t'u dërgohet të paktën dy operatorëve.

6. Në ftesën për negociata duhet të përcaktohen objekti i programit, ngjarjes, nevoja e kryerjes së programit/ngjarjes, fondi limit dhe data përfundimtare për paraqitjen e ofertës nga operatorët dhe agjencitë.

7. Komisioni pret, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata, konfirmimin nga operatorët/agjencitë e specializuara për vazhdimësinë e negociatave, i cili shoqërohet me çmimin përkatës për kryerjen e programit/ngjarjes, nga operatorët/agjencitë e specializuara. Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave vijnë në një ditë të vetme, të mbyllura dhe hapen njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit.

8. Komisioni, pas analizimit të ofertave të paraqitura, përzgjedh, në bazë të pikëve, operatorët/agjencitë e specializuara, duke u bazuar në kushtet e veçanta, të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, si dhe harton një raport të

hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, raport të cilin ia paraqet titullarit të institucionit.

9. Titullari i institucionit, në bazë të rekomandimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit, vendos, brenda 2 ditëve nga data e paraqitjes së rekomandimit, lidhjen e kontratave me operatorin/agjencinë e specializuar, për organizimin e ngjarjes.

III. Dispozita të fundit

10. Ankesat për procedurën e blerjes, të shërbimit dhe mallrave, për zhvillimin, prodhimin apo bashkëprodhimin e programeve kulturore, sociale dhe artistike nga operatorët e fushës bëhen te drejtuesi i institucionit. Vendimi i tij është përfundimtar.

11. Vendimi nr.309, datë 21.6.1993 i Këshillit të Ministrave "Për shpërblimin e cilësisë artistike në letërsi, artin figurativ, muzikor, kinematografik, ekzekutiv, interpretativ, si dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet kulturore", shfuqizohet.

12. Ngarkohen organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha